



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Besa Security" Sh.P.K. të datës 11.04.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "144 Mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Institucionet e Kryeqytetit, sheshet, hapësirat publike dhe nënkalimet" me nr. të prokurimit 616-24-2896-2-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pasafatshme kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Besa Security" Sh.P.K. e datës 11.04.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "144 Mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Institucionet e Kryeqytetit, sheshet, hapësirat publike dhe nënkalimet" me nr. të prokurimit 616-24-2896-2-2-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Besa Security" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Besa Security" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 11.04.2024 në ora 13:41 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër kundër njoftimit për kontratë të datës dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "144 Mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Institucionet e Kryeqytetit, sheshet, hapësirat publike dhe nënkalimet" me nr. të prokurimit 616-24-2896-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit. Përmes nenit 60 par. 1 nënpar. a) është përcaktuar se "Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)". Në rastin konkret sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, hapja e ofertave është paracaktuar me datë 16.04.2024 në ora 14:00. Kjo nënkupton që data 16.04.2024 është dita zero (0) ndërsa data e fundit kur kanë mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka qenë data 10.04.2024 deri në ora 16:00.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e datës 11.04.2024 është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 16.04.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.